



KONTRATA SOCIALE VAU I DEJËS

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT -DHJETOR 2021

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "HAPA TË LEHTË"



POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Gusht– Dhjetor 2021

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim”, Tiranë;
Qendra "Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës;
"Qendra Rinore" Vlorë;
"Shoqata për Integrimin e Zonave Informale", Kamëz;
Qendra "Epoka e Re", Fier;
"Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër;
"Lëvizja Rinore për Demokraci", Pukë;
"Qendra Rinore për Progres", Kukës;
"Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim", Progradec;
"Hapa të Lehtë", Vau i Dejës;
"Tjetër Vizion", Elbasan;
"Gruaja në Zhvillim", Korçë.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra “Hapa të Lehtë” në kuadër të projektit POP 2021 “Kontrata Sociale, mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetareve dhe pushtetarëve” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

Shkurtime	3
Falenderime	4
Hyrje	5
Metodologjia	6
Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale	6

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
UKT	Ujësjetës Kanalizime

Falenderime

Për të hartuar Raportin paraprak të vitit të parë të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Vau I Dejës dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara; Kryetarin e Bashkisë z. Mark Babani dhe gjithë stafin e bashkisë për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë vitit të parë të monitorimit të Kontratës Sociale të Vaut të Dejës.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Hapa të Lehtë të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2020, Rrjeti POP monitoroi zbatimin e kontratave sociale në 9 Bashki. Këto kontrata u hartuan bazuar në përparësitë e komunitetit në periudhën parazgjedhore 2019, dhe u nënshkruan nga kandidatët për kryetarë. Gjatë vitit të parë të mandatit në të gjitha bashkitë, u adresuan plotësisht 17% e prioriteteve, pjesërisht 58% e tyre dhe 25% e prioriteteve nuk janë adresuar akoma. Në këto kohë të vështira ku pandemia COVID-19 ka luajtur një rol të rëndësishëm është e nevojshme të përfshihen më shumë aktorë sesa vetëm qeveria dhe qytetarët. Këta aktorë mund të jenë përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile, sindikatave, etj. Prandaj, ky ishte edhe një nga qëllimet e POP gjatë vitit 2021 për përfshirjen e më shumë aktorëve në diskutime dhe vendimmarrje. Për më tepër, një qëllim tjetër i POP është që, përmes bashkëpunimit secila Bashki apo Kryetar i Bashkisë të përmbushë përparësitë e Kontratës Sociale brenda vitit 2023.

Qendra “Hapa të Lehtë” u bë pjesë e Rrjetit POP në vitin 2021 duke filluar aktivitetet e saj në muajin maj 2021.

Forumi për deklarimin dhe nënshkrimin e Kontratës Sociale¹ Vau i Dejës u organizua në datë 20 shtator 2021² dhe u finalizua me firmosjen e saj nga Kryetari i Bashkisë, z. Mark Babani, i cili mori përsipër që prioritetet kryesore të pasqyruara në këtë kontratë dhe të dala nga komuniteti i Vaut të Dejës do të jenë përparësi edhe e punës së tij gjatë mandatit deri në vitin 2023 kur do të zhvillohen zgjedhjet e ardhshme lokale.

Gjatë vitit 2021, projekti i POP vazhdon me “Kontrata Sociale si një mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetareve dhe pushtetarëve”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën gusht – dhjetor 2021.

Gjatë kësaj periudhe organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

¹ <https://popnetëork.al/kontrata-sociale-vau-i-dejes/>

² <https://popnetëork.al/6111-2/>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, Hapa të Lehtë, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Vau i Dejës dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën **gusht – dhjetor 2021**;
- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion, drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioriteteve të Kontratës Sociale.
- U organizuan takime me përfaqësues të bashkisë, Administratorë të Njësie Administrative dhe qytetarë të Vaut të Dejës, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit;
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Vau i Dejës, mbledhjet e organizuara gjatë pandemisë si edhe mbledhjet në vend.
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitin 2021 – 2022 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Vau i Dejës

Prioriteti nr.1 Transporti Publik.

Pavarësisht se mungesa e këtij shërbimi ndikon drejtpërsëdrejti të gjithë komunitetin, ai më së shumti ndikon në jetën socio ekonomike të grave dhe vajzave. Gratë dhe vajzat e kësaj bashkie për shkak të mentalitetit janë të detyruara, të lëvizin të shoqëruar nga një familjar tjetër, për shkak se duke mos patur një vendqëndrim dhe orar nisje, ato janë të detyruara të presin në rrugë deri kur të kalojë ndonjë makinë që bën transport, e cila bën të mundur lëvizjen e tyre në

drejtim të destinacionit që ato duan të shkojnë. Krahas kostos sociale, kjo shoqërohet edhe me kosto ekonomike sepse do të paguhen 2 bileta.

Prandaj për sa më sipër kërkohet:

- Sigurimi i transportit publik me orare, vend-nisje dhe vend-mbërritje të mirë përcaktuara që të mbulojnë të gjitha njësitë administrative dhe një kohështrirje përgjatë gjithë ditës.
- Tarifat e transportit të jenë jo vetëm sipas largësisë por edhe kategorive sociale.
- Publikimi i orareve të nisjes dhe të mbërritjes dhe respektimi i tyre.

Nga monitorimi rezulton se: Bashkia nuk e ka marrë në konsideratë këtë prioritet. Nuk ka buxhet për përmbushjen e tij.

Prioriteti nr.2 Kopshte /Çerdhe

Mungesa e këtij shërbimi ndikon më së shumti gratë dhe nënat e reja të cilat për shkak të kësaj mungese e kanë të pamundur të punësohen dhe të krijojnë pavarësi ekonomike.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e një çerdhe /kopshti me drekë. Kjo duhet të bëhet me tarifa të përballeshme për të gjitha familjet. Nga kjo tarifë, duhet me patjetër të perjashtohen familjet me ndihmë ekonomike apo nënat kryefamiljare.

Nga monitorimi rezulton se: Bashkia është duke identifikuar godinën që mund t'a përshtasë për ngritje e një çerdhe /kopshti me drekë.

Prioriteti nr.3 Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë të pijshëm, me orare të caktuara apo jashtë cilësisë ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave të cilat janë më së shumti në shtëpi dhe duhet të merren me gatimin, pastrimin e shtëpisë, rrobave me larjen e fëmijëve etj.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit në të gjitha fshatrat e të dy Njësitë Administrative Laç -Vau Dejes dhe Hajmel.

Nga monitorimi rezulton se: Kanë filluar punimet për rikonstruksion të ujsjellësit edhe në dy fshatra të Njësisë Administrative Vau i Dejës, konkretisht, në fshatin Shelqet dhe Mjedë.

Prioriteti nr.4 Biblioteka

Mungesa e bibliotekës, normalisht që ndikon në jetën e komunitetit në tërësi por mbi të gjitha

në jetën e të rinjve, të cilët e kanë kërkuar me ngulm ngritjen e saj.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Planifikimin për ngritjen dhe vënien në efijense të një biblioteke e cila duhet ti shërbejë të gjithë komunitetit por mbi të gjitha fëmijëve dhe të rinjve.

Nga monitorimi rezulton se: Aktualisht Bashkia nuk ka bërë ndonjë investim por ky investim është përfshirë në projektin për rikonstruksionin e Kinemasë, ku krahas Kinemase do ketë edhe Bibliotekën.

Prioriteti nr.5 Kinemaja

Mungesa e këtij institucioni kulturor ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e të rinjve në veçanti dhe të komunitetit në përgjithsi.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Rikonstruksion total i kinemasë dhe vënia në gjendje pune duke i rikthyer jetën e saj vitale socio- kulturore.
- Identifikimi i talenteve të reja, promovimi dhe mbështetja e tyre për të ecur përpara dhe për të gjallëruar jetën socio -kulturore.

Nga monitorimi rezulton se: Përmbushja e këtij prioriteti kërkon një investim shumë të madh. Eshtë hartuar projekti i rikonstruksionit por pritet nëse do të miratohet mbështetja nga Qeveria sepse Bashkia nuk ka fonde për t'a realizuar tërësisht me buxhetin e saj.

Prioriteti nr.6 Ndrichiimi

Normalisht që, mungesa e këtij shërbimi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejte tek gjithë komuniteti duke penguar levizjen e tyre gjatë orëve të natës por mbi të gjitha, ai ndikon në levizjen e grave dhe vajzave sepse ato nuk ndihen të sigurta natën, e për më tepër, kjo pasiguri shtohet kur rrugët nuk janë të ndricuara.

Për sa më sipër kërkohet që bashkia ti kushtojë një vëmendje të veçantë ndriçimit i cili duhet të mbulojë të gjitha lagjet e fshatrave të të gjitha njësive administrative.

- Fshati Mjedë ka nevojë emergjente për ndriçim
- Ndrichiimi i pedonales së fshatit Hajmel
- Ndrichiimi i lagjes Sumaj, Nj.A. Hajmel
- Ndrichiimi i fshatit Nenshat. Kërkohet nga banorët që të bëhet elektrifikim i plotë i fshatit duke qenë se rrjeti i vjetër është shumë i amortizuar dhe për pasojë shkaktohet humbje e madhe në rrjet duke sjellë mosfurnizim të familjeve me energji elektrike.

Nga monitorimi rezulton se: Bashkia i ka kushtuar një rëndësi të veçante ndriçimit në këto Njësi Administrative edhe pse jo te gjithë fshatrave të këtyre Njësive. Konkretisht janë prokuruar dhe

po vazhdojnë punimet për: Ndricimi në fshatin Kac dhe Spathar, ndriçim i qendrave të fshatrave Pistull dhe Dheu i Lehtë.

Prioriteti nr.7 Shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Në pjesën më të madhe të familjeve, ngarkesa familjare përballohet vetëm nga gratë, të cilat, krahas përkujdesjes për familjen e ngushtë duhet të kujdesën edhe për të moshuarit. Kjo barrë rëndohet edhe më shumë nëse pjestarë të familjes janë edhe personat me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë masa për ngritjen e qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për kategori në nevojë; për të rinjtë; gratë viktime të dhunës; të moshuarit etj.

Nga monitorimi rezulton se: Bashkia ka hartuar projekt fishen për ngritjen e një Qendre për persona me aftësi të kufizuara dhe pritjet të kalojë për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Prioriteti nr.8 Programe dhe shërbime të Bashkisë mbi adresimin e dhunës në familje

Statistikat në këtë bashki e vërtetojnë faktin se, viktime të dhunës janë kryesisht gratë, vajzat, si dhe fëmijët. Mungesa e shërbimeve për viktimat e dhunës ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave, të cilat për shkak të mungesës së shërbimeve mbështetëse për to, nuk denoncojnë dhunën por vazhdojnë të bashkëjetojnë me të.

Për sa më sipër kërkohet:

- Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.
- Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale.
- Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe ri-integruese për viktimat e dhunës në familje.

Nga monitorimi rezulton se: Viktimat e dhunës kanë prioritet në pikëzimin për pagimin e qerasë e banesave, por nuk ka pasur aplikime . Kanë vazhduar aktivitete ndërgjegjësuere për dhunën në familje gjatë 16 ditëve por edhe në vazhdimësi nga administratorët social. Po asistohen dhe monitorohen 13 raste viktime të dhunës në familje. Janë përmirësuar kushtet e banesës për një viktimitë të dhunës në familje me vlerë 1.500.000 mijë lekë.

KONTRATA SOCIALE

POP
PERBALLJA OFERTAVE POLITIKE

PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA BASHKIA VAU DEJËS

SHTATOR 2021

Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare

Kjo kontratë sociale është hartuar duke përfshirë prioritetin nga këmbëngulësi / propozitivet e përgjigshme gjinore.

Prioriteti 1: ● Transporti Publik.

Provokuesit se mungesa e këtij shërbimi ndikon drejtpërdrejtë në gjithë komunitetin, si më së shumti ndikon në jetën socio ekonomike të grave dhe vajzave. Gratë dhe vajzat e këtyre bashkive për shkak të merrtësisë janë të detyruara, të lëvizin të shoqëruar nga një familjar tjetër, për shkak se duke mos parur një vendndërim dhe ora njeje, ato janë të detyruara të presin në muqë deri kur të kalojë ndonjë makinë që bën transport, e cila bën të mundur lëvizjen e tyre në drejtim të destinacionit që ato duan të shkojnë. Krahas kostos sociale, kjo shoqërohet edhe me kosto ekonomike sepse do të paguhet 2 blota.

Prendaj për sa më shpejt kërkohet:

- Sigurimi i transportit publik me orare, vend njeje dhe vend mbajtjeje të mirë përcahuara që të mbulojë të gjitha njësitë administrative dhe rrejtë kohëzotuese përgjatë gjithë ditës.
- Tarifat e transportit të jenë jo vetëm sipas largësisë por edhe kategorive sociale.
- Publikimi i orareve të njeje dhe të mbajtjeje dhe respektimi i tyre.

Prioriteti 2: ● Kopshtë /Qendër

Mungesa e këtij shërbimi ndikon në të shumtë gratë dhe nënat e reja të cilat për shkak të këtyre mungesave kanë të pamundur të punisohen dhe të kuptojnë paratë ekonomike.

Prendaj për sa më shpejt kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë në gjithë masat e nevojshme për ngritjen e një qendër/kopshti me dritë. Kjo duhet të bëhet me tarifa të përballueshme për të gjitha familjet. Nga kjo tarifë, duhet me pasiguri të përpastohen familjet me ndihmë ekonomike apo nënat kryetarimjare.

Prioriteti 3: ● Familjet me ujë të pijshëm dhe kanalizim

Familjet me ujë të pijshëm, me orare të caktuara apo jashtë cilësive ndikon në mirënjohje të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave të cilat janë më së shumti në shërbim dhe duhet të marrin me gatim, pastimin e shërbimit, robave me larjen e fëmijëve etj.

Prendaj për sa më shpejt kërkohet:

- Familjet pa ndërrrejtje me ujë të pijshëm dhe përmirësimi i cilësive të ujë të gjitha fshatrat e të dy Njësitë Administrative Laç - Vau Dejës dhe i lagjeve.

Prioriteti 4: ● Biblioteka

Mungesa e bibliotekës, normalisht që ndikon në jetën e komunitetit në tërësi por mbi të gjitha në jetën e të rinjve, të cilët e kanë kërkuar me ngulm ngritjen e saj.

Prendaj për sa më shpejt kërkohet:

- Planifikimin për ngritjen dhe vlerën në ofertesë të një bibliotekë e cila duhet të shërbejë të gjithë komunitetin por mbi të gjitha fëmijëve dhe të rinjve.

Prioriteti 5: ● Kinemaja

Mungesa e këtij institucioni kulturor ndikon në mirënjohje të drejtpërdrejtë në jetën e të rinjve në voparit dhe të komunitetit në përgjithësi.

Prendaj për sa më shpejt kërkohet:

- Rekonstruksion total i kinemasë dhe vlerën në gjendje pune duke i rritur jetën e saj vitale socio - kulturore.
- Identifikimi i talentëve të reja, promovimi dhe mbledhja e tyre për të cur përpara dhe për të gjuhëzuar jetën socio - kulturore.

Prioriteti 6: ● Ndërrrejtje

Normalisht që, mungesa e këtij shërbimi ndikon në mirënjohje të drejtpërdrejtë tek gjithë komuniteti duke penguar lëvizjen e tyre gjatë orëve të natës por mbi të gjitha, si ndikon në lëvizjen e grave dhe vajzave sepse ato nuk ndihen të sigura natën, e për më tepër, kjo penguar shpesh kur muqë nuk janë të ndërrrejtura.

Për sa më shpejt kërkohet që bashkia të kuptojë një vlerëzje të voparit ndërrrejtje i cili duhet të mbulojë të gjitha lagjet e fshatave të të gjitha njësitë administrative.

- Fshati Mjollë ka nevojë emergjente për ndërrrejtje
- Ndërrrejtje i pedonalëve në fshatin i lagjeve
- Ndërrrejtje i lagjes Surrus, N.A. i lagjeve
- Ndërrrejtje i fshatit Nerehat. Kërkohet nga banorët që të bëhet rindërtim i plotë i fshatit duke orarë se rrjetit i vjetër është shumë i amortizuar dhe për pasiguri shkaktohet humbje e madhe në rrjet duke sjellë modernizim të familjeve me energji elektrike.

Prioriteti 7: ● Shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Në pjesën më të madhe të familjeve, ngarkesa familjare përballëhet vetëm nga gratë, të cilat, krahas përvojës për familjen e ngarkuar duhet të kujdesin edhe për të moshaun. Kjo bën rëndësishëm edhe më shumë një qendër të familjes janë edhe personat me shërbim të kujdesit.

Për sa më shpejt kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë masa për ngritjen e qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë, për të rinjtë, gratë vdiqim të dhunës, të moshaun etj.

Prioriteti 8: ● Programe dhe shërbime të bashkëveprimi mbledhës e dhunës në familje

Statistikat në këto bashkë evidencojnë faktin se, vdiqim të dhunës janë kryesisht gratë, vajzat, si dhe fëmijët. Mungesa e shërbimeve për vdiqim e dhunës ndikon në mirënjohje të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave, të cilat për shkak të mungesës së shërbimeve mbledhëse për ta, nuk donozojnë dhunën por vuqndojnë të bashkëveprimi me të.

Për sa më shpejt kërkohet:

- Zgjedhim i programeve ndërrrejtjeve dhe informacione që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasiguri e saj.
- Ngritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale.
- Zgjedhim i shërbimeve ofruesve mirënjohës, kujdesin dhe të integruar për vdiqim e dhunës në familje.

Organizata
"I lapa të Letës"

Denada SHPUZA

Kryetar i Bashkisë
Vau i Dejës

Mark BABANI